



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:262350  
Datë: 07.05.2024  
Numri i dokumentit: 05691970

**Ac.nr.3925/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. S., nga Prishtina, rr. “K.”, /1., të cilin me autorizim e përfaqëson M. M., avokat nga Peja, kundër të paditurës Universiteti “H. Z.”, Pejë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit L. L., zyrtar për përfaqësime pranë këtij universiteti, objekti i kontestit kompensimin i të ardhurave personale, vlera e kontestit 7842,00€, duke vendosur sipas ankesës palëve ndërgjyqëse, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1396/19, datë 26.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** në tërësi e bazuar ankesa e paditësit M. S., nga Prishtina, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1396/19, datë 26.03.2021 në pikën II (dy) të dispozitivit dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.
- II. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës Universiteti “H. Z.”, Pejë, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1396/19, datë 26.03.2021 në pikën III (tre) të dispozitivit dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.
- III. REFUZOHET** ankesa e të paditurës Universiteti “H. Z.”, Pejë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1396/19, datë 26.03.2021 në pikën I, VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë me aktgjykimin numër C.nr.1396/19, datë 26.03.2021, ka vendosur: APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia paditësit M. S., nga Prishtina, rr. "Kalabria", ..1.. I. DETYROHET i padituri Universiteti "H. Z.", Pejë, që paditësit M. S., t'ia paguaj në emër të tri pagave përcjellëse në pension shumë prej 4,567.89 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit e cila do të llogaritet nga data 12.11.2019 (data e parashtrimit të padis), e të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimit e përmbarimit të dhunshëm. II. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit M. S., përtej shumës së gjykuar, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me të cilën ka kërkuar të detyrohet i padituri që paditësit t'ia paguaj në emër të pagave të pa realizuara nga dt.14.06.2019 e deri me dt. 30.09.2019 shumë prej 4,820.81. III. OBLIGOHET i padituri Universiteti "H. Z.", Pejë, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet procedurale në shumë prej 700,00 Euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe atë vetëm sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si dhe ta obligoj të paditurën që paditësit t'ia paguajë shpenzimet për përpilimin e ankesës dhe taksës gjyqësore.

Po ashtu edhe e paditura përmes përfaqësuesit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e të njëjtës të aprovohet si e bazuar ndërsa aktgjykimin i ankimuar të prishet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesat e paditësit është e themeltë.
- Ankesa e të paditurës është e pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datën 12.11.2019, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të të ardhurave personale. Në padi ka pretenduar se i njëjti ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën, si mësimdhënës me titull profesor i asociuar deri në moshën e pensionimit dhe pas pensionimit i njëjti ka vazhduar të punojë me të paditurën në cilësinë e anëtarit të komisioneve për vlerësimin e punimeve të temave të masterit si dhe të organeve tjera të Universitetit. I njëjti pas pensionimit i është drejtuar të paditurës për realizimin e kompensimit për tri paga me rastin e pensionimit dhe katër paga të pa paguara, mirëpo meqenëse e njëjta është refuzuar me padi ka kërkuar që e paditura t'ia kompensojë gjithsej për këto paga shumë prej 7,842.00 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit që do ti llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe pas administrimit të provave të përshkruara dhe elaboruara në pjesën e arsyetimit të vendimit ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.243/2019, i datës 25.06.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi sipas kontratës me numër 1951/16 e dt.10.10.2016 ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura. Nga provat e administruara si vendimi me numër të protokollit nr.2295 i dt. 01.08.2019, i lëshuar nga Universiteti "H. Z.", gjykata vërtetoi fakti se paditësi M. S., ka arritur moshën gjashtëdhjetë e pesë vjeçare dhe e ka plotësuar kushtin për pensionim ndërsa në bazë të vendimit me numër protokollit 2020 i dt.05.07.2019, i lëshuar nga Universiteti "H. Z.", vërtetoi se Këshilli i Fakultetit të Biznesit në mbledhjen e mbajtur me dt. 17.06.2019, ka miratuar raportin e mentorit dhe ka formuar komisionin ku kryetar komisioni ka caktuar Prof. Asoc. Dr. M. S., për të bërë vlerësimin e punimit të temës se masterit për kandidatë.

Më tutje ka theksuar se me qëllim të vërtetimit të lartësisë së kërkesë padisë, sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse gjykata ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare e cila është punuar në mënyrë profesionale nga eksperti financiar gjyqësor A. Sh., ecc.dip me datë 30.11.2020, e po ashtu edhe nga sqarimi i të njëjtit ekspert bërë në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 11.03.2021, ku nga kjo ekspertizë, dhe sqarimi i së njëjtës në seancë nga eksperti, është vërtetuar se lartësia e shumes për tri pagat përcjellëse që i takojnë paditësit pas pensionimit është 4,567.89 euro. Ndërsa për pjesën refuzuese ka theksuar se pasi paditësit i është ndërprerë kontrata e punës me rastin e arritjes së moshës së pensionimit sipas fuqisë ligjore dhe pretendimi i paditësit se edhe pas pensionimit ka kryer disa punë të mbetura pranë universitetit të paditur dhe këtë pretendim e mbështet në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.03/13, të dt. 27.03.2008 ku parashihet se punonjëseve të personelit akademik/mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës që kanë mbushur moshën 65 vjeçare, pasi të ketë filluar viti shkollor, iu vazhdohet kontrata e punës deri në përfundimin e vitit akademik, ky pretendim nuk qëndron për faktin se paditësi nuk ka qenë i angazhuar si staf akademik në Universitetin e Prishtinës por në Universitetin e Pejës, e po ashtu gjykatës nuk i ka paraqitur ndonjë provë-vendim se të njëjtit i është vazhduar kontrata e punës deri në përfundimin e vitit akademik siç parashihet me këtë vendim.

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 35, paragrafi 9 i kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë lidhur me nenin 245 të LMD-së dhe 67, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të Ligjit të Punës. Për kamatën i është referuar nenit 382 të LMD-së dhe për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 449, 452,453 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar ankesën e të paditurës dhe nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në pikën I (një) të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar që ka të bëjë me detyrimin e kompensimit të pagave për përcjelle në pension, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar në këtë pjesë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit çdoherë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit në vlerësim të pretendimeve ankimore të të paditurës, ka gjetur se ankesa është e pa bazuar në pjesën e pikës II (dy) të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, që ka të bëjë me vendosjen për paga përcjellëse për pension. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara, ngase nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka punuar tek e paditura si Profesor i Asocuar në Universitetin “H. Z.”, e kjo në bazë të kontratës së punës me nr. protokollin 2026, e datës 10.10.2016, nga data 03.10.2016 deri më datë 02.10.2020, kontratë kjo e lëshuar nga e paditura dhe se i njëjti sipas Vendimit 2295/1, të datës 01.08.2019, me po të njëjtën datë është pensionuar. Andaj gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagave për përcjellje në pension, në shumën prej 4,567.80 €, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale dhe me të drejtë është bazuar në dispozitën e nenit 35 paragrafi 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 ku parashihet që *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”*, 9.1. *Pagat përcjellëse paguhen nga punëdhënësi i fundit dhe jo më larg se 30 ditë, nga dita e pensionit ”*.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar pretendimet ankimore, ka gjetur se ankesa e paditësit është e bazuar në pjesën e pikës II (dy) të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, ngase në këtë pjesë kemi shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së pasi që dispozitivi i aktgjykimit në këtë pjesë është në kundërshtim me arsyet e dhëna sipas të njëjtit aktgjykim. Po ashtu faktet vendimtare janë kundërtëhënëse midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet lidhur realizimin e pagave të pa papaguara, andaj në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, duke mos e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit për këto pika, ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin material (neni 184 i LPK-së).

Gjykata e Apelit i vlerëson si të bazuara pretendimet ankimore të paditësit në lidhje me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e që si rrjedhojë ka pasur edhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale për faktin se vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike konsiston në atë se nga provat e administruara nuk ka arritur të vërtetohen faktet vendimtare lidhur me kompensimin e pagave të pa realizuara për periudhën 14.06.2019 e deri më datë 30.09.2019, në shumë prej 4,820.18 €. Gjykata e shkallës së parë lidhur me kërkesën e paditësit për realizimin e pagave të pa papaguara për këtë periudhë, ka theksuar se paditësit një e drejtë e tillë nuk i takon pasi që të njëjti i është ndërprerë kontrata e punës sipas fuqisë ligjore dhe atë me arritjen e moshës së pensionimit duke mohuar faktin se i njëjti pas pensionimit ka qenë i angazhuar si staf akademik. Gjykata ka arsyetuar se *“paditësi nuk ka qenë i angazhuar si staf akademik në Universitetin e Prishtinës pasi që i njëjti ka qenë i angazhuar në Universitetin e Pejës”*, mirëpo gjykatës nuk i ka paraqitur ndonjë provë, vendim se të njëjtit i është vazhduar kontrata e punës deri në përfundimin e vitit akademik siç parashihet me vendimin Nr.03/13, të datës 27.03.2008. Në rastin konkret referuar shkresave të lëndës si edhe nga thëniet në aktgjykim, rezulton se është fakt jo kontestues se paditësi sipas kontratës me numër 1951/16, të datës 10.10.2016 ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura deri në moshën e pensionimit (*vendimi për pensionim 2295, i datës 01.08.2019, i lëshuar nga e paditura*). Në bazë të vendimit me nr. protokollin 2020, të datës 05.07.2019, e paditura e ka angazhuar paditësin si kryetar të komisionit për vlerësimin e temës së masterit për kandidatë dhe nga ky angazhim paditësi si provë për të dëshmuar angazhimin

e tij ka sjellë Vendimin nr.2020, të datës 05.07.2019, Vendimin nr.2028, i datës 05.07.2019, Vendimin Nr.2046, i datës 05.07.2019, Vendimin Nr.2039, i datës 05.07.2019 si edhe Vendimin nr.2036/1, të datës 05.07.2019. Andaj gjykata e shkallës së parë në rastin konkret nuk ka sqaruar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, përkatësisht nuk e ka argumentuar drejtë një gjendje të tillë, duke dhënë vlerësime se pse është angazhuar paditësi, dhe nëse parashihet kompensim për një angazhim të tillë.

Për këto arsye, aprovohen si të bazuara pretendimet ankimore lidhur me këto shkelje dhe me rastin e marrjes së lëndës në rishqyrtim dhe rivendosje, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të ndërmarrë veprime të caktuara për eliminimin e shkeljeve të përmendura si më lartë, në pajtim me dispozitat imperative ligjore, ashtu që ta vërtetoi plotësisht dhe drejtë gjendjen faktike duke vlerësuar të gjitha provat e bashkangjitura në shkresa të lëndës dhe pas vërtetimit të gjitha fakteve dhe kryerjes së të gjitha veprimeve që i ka për obligim si gjykatë, e njëjta udhëzohet që të vendosë drejtë lidhur me rastin, duke i shqyrtuar dhe arsyetuar edhe të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse. Po ashtu, për sa i përket vërtetimit të fakteve që janë ngritur nga pala paditëse, gjykata e shkallës së parë udhëzohet të ofrojë vlerësime lidhur me provat e ofruara me të cilat paditësi është angazhuar nga e paditura pas daljes në pension. Ngase në shkresa të lëndës gjenden prova se paditësi ka nënshkruar raport për studentët e notuar, mentorim të kandidatëve, të cilat gjykata nuk i ka analizuar, prandaj me qëllim të vendosjes së drejtë të rastit, duhet ofrojë vlerësime se cili ishte qëllimi i angazhimit të paditësit pas pensionimit, a parashihej kompensim për angazhime të tilla. Në fund, udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozita e neni 160 të LPK-së (të hartoj dispozitivin e aktgjykimit në përputhje me parag.3 të nenit 160 të LPK-së, si dhe të jap arsyetimin në pajtim me parag.4 të këtij neni), ashtu që pas administrimit të provave të propozuara nga të dyja palët ndërgjyqëse dhe vlerësimit të arsyetuar detajisht të provave që i shqyrton dhe i administron, të vendosë për kërkesëpadinë e palës paditëse, në bazë të ligjit, përfshirë këtu edhe për shpenzimet e procedurës.

Në lidhje me vendimin për shpenzimet gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar ankesën e të paditurës në këtë pjesë, sepse shpenzimet duhet të përcaktohen në mënyrë unike për të gjitha shpenzimet e pranueshme në përfundim të vendosjes meritore për të gjitha kërkesat.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 195.1 pika (c) të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**Ac.nr.3925/2021, datë 07.05.2024**

**Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari**  
**Dardan Kadolli**